



## KOMUNIKATË

**7.09.2009**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sot në mbledhjen e 27 –të me radhë debatoi rreth detyrave dhe përgjegjësi që dalin nga procesi i përgaditjes dhe organizimit të zgjedhjeve Lokale të 15 nëntorit. Anëtarët e KQZ, pasi që aprovuan rendin e ditës me disa propozime për diskutim në pikën “të ndryshme” dhe raportin e mbledhjes së KQZ-së të 25-të, u informuan me shkrim lidhur me aktivitetet e Kryetares së KQZ, Nesrin Lushta, si dhe me informacionet nga SKQZ. Në vazhdim të mbledhjes, drejtoresha e ZRPP-së, Miradie Mavriqi, i njoftoi anëtarët e KQZ-së me aktivitetet e kësaj zyre. Mavriqi, tha se zyra i rekomandon KQZ-së që të bëjë certifikimin e subjektit “Inisiativa qytetare për komunën e Ranillugut” me akronimin GIZOR, në cilësinë e subjektit politik. Gjithashtu, u rekomandua që të aprovohet kërkesa e OJQ-së Instituti Demokratik i Kosovës – KDI, që t’i vëzhgojë zgjedhjet. KQZ, aprovoi të dy këto kërkesa të ZRPP-së.

Në vazhdim të mbledhjes, anëtarët e KQZ-së u informuan lidhur me punën e Këshillit të Personelit, Këshillit të Buxhetit dhe të Prokurimit, si dhe të Këshillit të Operacioneve Zgjedhore. Debatet me këtë rast, u fokusuan ndër të tjera në njoftimet për rekrutimet e fazës së III-së të pozitive të përkohshme në QNR, në specifikat e prodhimit të kartave të identitetit për vëzhguesit e zgjedhjeve në KKV-të dhe QNR, për Doracakun mbi votimin dhe bumërimin në vendvotime, për raportin e vizitës së ekipit të KQZ/SKQZ në Mal të Zi etj. KQZ, miratoi shumicën nga çështjet që kishin të bënin me punën e këshillave, ndërkaq rekomandoi që buxheti për KQZ-në për vitin 2010 -2012, të shqyrtohen edhe njëherë. Gjithashtu, u aprovua kërkesa që Votimi me Postë të shtyhet deri më 15 shtator.

Në këtë mbledhje, në pikën në të ndryshme, u folë lidhur me projektin për Informimin Publik, për freskimin e Web Faqes së KQZ-së, për Shërbimin Votues etj.